



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2025:007059

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06784199

KPPP.nr.42/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Ingram Micro Makedonija”, me numër fiskal MK 4057015528989, me seli në Maqedonia e Veriut, përfaqësuar sipas autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Art House” SH.P.K., me NUI: 810542151, me seli në Prishtinë, rruga “Kastori”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Vegim Kraja, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.629/24 të datës 27.12.2024, të Përmbartuesit Privat Arsim Bajraktari, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 31.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Art House” SH.P.K., ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.629/24 i datës 27.12.2024, i Përmbartuesit Privat Arsim Bajraktari, për pjesën sa i përket detyrimit për ndëshkimin ditor në shumë prej 1,454.5 €, nga data 05.11.2024 e përcaktuar sipas pikës II të Ujdisë Gjyqësore me numër 2024:076332 të datës 25.09.2024.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Art House” SH.P.K., MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.629/24 të datës 27.12.2024, të Përmbartuesit Privat Arsim Bajraktari, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 76,014.36 € (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërmëdhjetë euro e tridhjetë e gjashtë cent).
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “Ingram Micro Makedonija”, sipas urdhit përmbartimor P.nr.629/24 të datës 27.12.2024, të Përmbartuesit Privat Arsim Bajraktari, për pjesën sa i përket detyrimit për ndëshkimin

ditor në shumë prej 1,454.5 €, nga data 05.11.2024 e përcaktuar sipas pikës II të Ujdisë Gjyqësore me numër 2024:076332 të datës 25.09.2024.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Ingram Micro Makedonija”, me seli në Prishtinë, në bazë të titullit ekzekutiv - Ujdia Gjyqësore e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike, 2024:076332 të datës 25.09.2024, ka nxjerr urdhrin përmbarimor P.nr.629/24 të datës 27.12.2024, me të cilin është detyruar debitori që sipas kësaj ujdie gjyqësore të lartcekur kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 76,014.36 €, ndëshkimin ditor prej 1,454.5 € nga data 05.11.2024 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim në shumë prej 487.00 € sipas TOAK, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve duke filluar nga dita e pranimit të urdhrin përmbarimor, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorëve, si dhe me regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme të debitorëve.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se debitori në lidhje me kryegjënë ka përmbushur 71% të borxhit kryesor. Tutje ka shtuar se debitori e konteston pjesën sa i përket ndëshkimit ditor për shkak se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LMD-së, përkatësisht në bazë të nenit 253 paragrafi 2 përcaktohet se dënimi kontraktues mund të lidhet vetëm në rastet kur debitori vonohet në përmbushjen e detyrimit jo monetar, përkatësisht në dorëzimin e punëve kontraktuese, ndërsa në rastin konkret detyrimi i debitorit është në para, andaj kërkesa e debitorit është e pabazuar në dispozita ligjore dhe si e tillë e pavlefshme. Ka shtuar se nëse gjykata konstaton se dënimi i kontraktuar është i vlefshëm i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta zvogëloj pasi që është shumë e lartë. Sa i përket ujdës gjyqësore ka deklaruar se e njëjta është bashkangjitur në kopje dhe si e tillë nuk ka tipare të përmbarueshmërisë. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet si dhe procedura përmbarimore të përfundohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarimor paraqet titull përmbarimor dhe i njëjti ka tipare të përmbarueshmërisë. Tutje ka shtuar se debitori nuk e ka

kontestuar kryegjënë i njëjti ka kontestuar vetëm pjesën e dënimit kontraktual duke pretenduar se e njëjta është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LMD-së, në rastin konkret kreditori dhe debitori për shkak të kontestit që ishte duke u zhvilluar pranë gjykatës komerciale me datë 25.09.2024, përmes aktvendimit me numër të lëndës 2024:076332 kanë arritur pajtim gjyqësor ku ndër të tjerash është arritur pajtim edhe për ndëshkim në rast të vonesës në përmbushjen e detyrimit, e që i njëjti ka përmbushur 70.91% të borxhit ndërsa ka mbetur 29.09% borxh ndaj kreditorit, meqenëse sipas marrëveshjes ndëshkimi është përcaktuar në shume prej 5,000.00 € në ditë për pjesën e borxhit të mbetur ndëshkimi ditor është llogaritur në shumë prej 1,454.50 €. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor si dhe të obligohet debitori që kreditorit t'ia kompensoj shpenzimet e përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumë prej 650.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Sipas dokumentit përmbarues (titullit ekzekutiv) - Ujdisë Gjyqësore me numër 2024:076332 të datës 25.09.2024, në pikën I të dispozitivit është obliguar i padituri (këtu debitori) që paditësit (këtu kreditorit), t'ia kompensoj shumën prej 261,340.82 € në emër të borxhit sipas faturës nr. 23-390-00186 të datës 23.01.2023 dhe faturës nr.23-390-00454 të datës 15.02.2023, më së largu deri me datë 21.10.2014. Në pikën II është obliguar i padituri (debitori) që në rast të mospërmbushjes së obligimit sipas pikës I deri më datë 21.10.2024, në emër të ndëshkimit, paditësit t'ia kompensoj shumën prej 5,000.00 € për çdo vonesë.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Ujdinë Gjyqësore me numër 2024:076332 të datës 25.09.2024, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin

dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues.

Me nenin 24 par. 1 të LPP-së përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i pambarueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret – Ujdia Gjyqësore me numër 2024:076332 e datës 25.09.2024, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 24 par. 1 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i pambarueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*, ngase ujdia gjyqësore ka tipare të përmbarueshmërisë nga momenti i lidhjes së saj.

Po ashtu Ujdia Gjyqësore, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti, shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Andaj Gjykata refuzoi pjesërisht prapësimin e debitorit, duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.629/24 të datës 27.12.2024, për shumën në vlerë prej 76,014.36 €, në emër të borxhit kryesor, për faktin se Ujdia Gjyqësore mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet për të qenë dokument i përmbarueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me neni 21, 22, 23, 24 dhe 27 të LPP-së.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr.629/24 i datës 27.12.2024, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar në emër të ndëshkimit ditor në shumë prej 1,454.50 €, nga data 05.11.2024 e deri në pagesën definitive e përcaktuar sipas pikës II të Ujdisë Gjyqësore me numër 2024:076332 të datës 25.09.2024, për shkak se e njëjta

është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht me nenin 253 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me të cilën përcaktohet se *“Kreditori dhe debitori mund të kontraktjnë që debitori t`i paguajë kreditorit një shumë të caktuar të hollash ose t`i sjellë ndonjë përfitim tjetër material në qoftë se nuk e përmbushë detyrimin e tij ose vonohet me përmbushjen e tij. (dënimi kontraktues)”*, ndërsa me paragrafin 3 të po të njëjtit nen është përcaktuar se *“Dënimi kontraktues nuk mund të kontraktohet për detyrime në të holla”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se dënimi i kontraktuar sipas Ujdisë Gjyqësore me numër 2024:076332, të datës 25.09.2024, është në kundërshtim me dispozitën ligjore të sipërcituar, andaj gjykata aprovoi pjesërisht prapësimin dhe anuloi urdhrin përmbarimor për pjesën e ndëshkimit ditor.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë -Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.42/25, datë 31.01.2025

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.